



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 594 / Prot.

Patos, më 11/07/2025

MIRATOHET  
KRYETARI  
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 38, datë 11/07/2025

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE  
NË RAST FATKEQËSIE TË SHKAKTUAR NGA RËNIA E ZJARRIT NË  
BANESË DHE HUMBJEN E JETËS SË Z. SABRI SERDARI NË FSHATIN  
VERBAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE ZHARRËZ**

### KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” ligjit nr. 44/2015 “Kodi procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, neni 113, pika 3, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3.1, shkronja a), kërkesës me nr. 594 prot., datë 26.02.2025 të këshilltarit Erald Çepel për z. Alburant Serdari i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë masën e ndihmës financiare prej 500,000 (pesëqind mijë) lekë në rastin e humbjes së jetës të anëtarëve të familjes.
2. Vlera e kësaj ndihme do të mbulohet nga “Fondi i mbrojtjes civile” nga të ardhurat vendore.

### EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

Të Mbrojtjes nga Zjarri, shpëtimit dhe Mbrojtjes Civile.

Drejtues të Programit

Ermenita MICI

Alket HALIMI

ANËTARË

Arben SHPËRDHEJA

Florian TORO

Mimoza SITËMBARI

Juriste  
Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCIVE CIVILE

Nr. 594 / Prot.

12

Patos, më 11/07/2025

## RELACION

### PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NË RAST FATKEQËSIE TË SHKAKTUAR NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESË DHE HUMBJEN E JETËS SË Z. SABRI SERDARI NË FSHATIN VERBAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE ZHARRËZ

#### KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Nisur nga kërkesa e përsëritur, me nr. 594 prot., dt. 26.02.2025 e këshilltarit Erald Çepele për z. Alburant Serdari ku në kërkesë shprehet për ndihmë financiare, pasi si pasojë e zjarrit të rënë në banesë babai i tij ka ndërruar jetë. Kjo e vërtetuar me skedën e vdekjes dt. 27.04.2022. Z. Alburant Serdari ka paraqitur kërkesën me nr.1155 prot., datë 10.05.2022, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në banesë dhe për ndihmë për rehabilitimin e saj. Për verifikimin e kërkesës së qytetarit është ngritur komisioni me urdhërin nr. 80, datë 06.05.2022. Komisioni ka shkuar në terren dhe ka mbajtur procesverbal më datë 10.05.2022, mbi dëmet e shkaktuara nga kjo fatkeqësi. Në bazë të pikës 2 dhe shkronjës a) të pikës 3 të kapitullit III të V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” i ndryshuar, përcaktohet “Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare”: a) Procesverbali i konstatimit të gjendjes; b) Vendim i këshillit të komunës ose i bashkisë; c) Preventivat e dëmeve nga ana ndërtimore në objektet e banimit, si dhe dëmet në orendi, mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake; ç) Çertifikata familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë; d) Çertifikata e vdekjes së pjestarit të familjes, kur ka raste të tilla, shoqëruar me vërtetimin e komisionit mjeko-ligjor, sipas rastit; dh) Akt-ekspertiza nga PMNZSH-ja, në raste zjarri dhe vërtetimi nga Policia e Shtetit ose prokuroria e rrethit, në raste eksplozivi; e) Studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licensuara nëse është rrëshqitje toke; ë) Konfirmimi i vendimit të njësisë së qeverisjes vendore për bazueshmërinë ligjore nga ana e institucionit të Prefektit të qarkut; f) Shkresa nga njësitë e qeverisjes vendore dhe këshilli i qarkut, ku të shprehet masa e ndihmës së dhënë për familjen e dëmtuar, në rast se ka, ose pamundësia financiare për ta ndihmuar, për mungesë fondesh.

Pika 3. Përcaktimi i ndihmës financiare. a) Masa e ndihmës financiare që Këshilli i Ministrave ose Ministria e Brendshme akordon në rastin e humbjes së jetës së anëtarëve të familjes, si pasojë e fatkeqësisë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për çdo person të

vdekur. Në mbështetje të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, i ndryshuar, V.K.M-së nr. 414, dt. 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, pika 3.1 shkronja a) akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilave janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera sipas kriterëve specifike të përcaktuara në aktet nënligjore që rregullojnë ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, neni 41, “E drejta e kompesimit”, pika 2) dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile, për këto arsye i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

Të miratojë masën e ndihmës financiare **prej 500,000 (pesëqind mijë) lekë** në rastin e humbjes së jetës të anëtarëve të familjes.

Vlera e kësaj ndihme do të mbulohet nga “Fondi i mbrojtjes civile” nga të ardhurat vendore.

### **EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT**

Të Mbrojtjes nga Zjarri, shpëtimit dhe Mbrojtjes Civile.  
Drejtues të Programit

Ermenita **MICI**

Alket **HALIMI**

**ANËTARË**

Arben **SHPËRDHEJA**

Florian **TORO**

Mimoza **SHTËMBARI**

**KRYETARI**  
**Fation Duro**

